



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025 | Nr: 94 | Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 14, DATË 12.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: Z. Erlind Sulo
Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Z. Maksim Et'hemaj
Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil

Z. Gentian Gjyli
Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar

Z. Ani Hasa
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë

Z. Kreshnik Bajraktari
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës

OBJEKT: Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë



BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

K O N S T A T O J :

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 12.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 14 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë duke u përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare, e Institucione në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si:

- 1. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;*
- 2. Autoriteti i Aviacionit Civil;*
- 3. Autoriteti Rrugor Shqiptar;*
- 4. Agjencia për Efiçencën e Energjisë;*
- 5. Autoriteti Portual Durrës.”*

Nga sa më sipër çmtoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Z. Erlind Sulo, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore;
- Z. Maksim Et’hemaj, Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Z. Gentian Gjyli, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- Z. Ani Hasa, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë;
- Z. Kreshnik Bajraktari, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës.



2. Rezultatet e këtij Vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

